



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.973/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.I “Q.G.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.G., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim tatimor, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1113/18, të datës 25.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.28.04.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1113/18, i datës 08.03.2021, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur I. APROVOHET në tersi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit BI “Q.G.”, me seli në Prishtinë, Rr. “UÇK”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.G.. II.ANULOHET aktvendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr. 63/2018, i datës 04.04.2018. III.OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë,

që paditësit, BI “Q.G.”, me seli në Prishtinë, Rr. “UÇK”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.G., t’ia njoh si kreditim me të drejtë rimbursimi shumë e mbetur prej 1,378.42 euro, (një/tre/shtatë/tetë/euro/e/katër/dy/cent) nga periudha tatimore 04/2004 për TVSH-ë, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit ligjor.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij Aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës ATK, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1113/18, i datës 08.03.2021, apo çështja të kthehet në Gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin nr.63/2018 i datës 04.04.2018, në pikën I të dispozitivit Refuzohet si e pa bazë ankesa në procedurë nr.63/2018 e datës 09.02.2018 e subjektit BI “Q.G.” me numër të regjistrimit të biznesit NRB 34007547 si dhe numër fiskal NRF 600520581 me pronar Q.G. me seli të biznesit rr. UCK Prishtinë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative, në lidhje me nenin 89 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll vërtetohen si të bazuara. Procedura e ankesës nuk ndërprente sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti tani paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës

25.02.2021, në prani të autorizuarit të palës paditëse si dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se; Gjykata konsideron se në arsyetimin e vendimit kontestues nuk është dhënë vlerësimi i saktë i shumës së kërkuar për rimbursim për periudhën kontestuese 04/2004 dhe llojin e tatimit TVSH-ë, sepse edhe sipas vet Departamentit të Ankesave pranë ATK-së, këtu të paditurës e cekur edhe në arsyetim të vendimit kontestues, është theksuar se tatimpaguesi këtu paditësi për periudhën tatimore 04/2014, për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ka realizuar rimbursimin në shumën prej 4,149.81 euro, kjo sipas ekspertizës financiare nr. 112/17 e datës 24.11.2017, e ekspertit financiar V.I., i angazhuar në lëndën A nr. 164/14 datë 16.01.2018, mirëpo kjo gjendje faktike nuk është në harmoni me vet dokumentet e ATK-së, këtu të paditurës të datës 12.07.2012 dhe 14.09.2012. Gjykata konstaton se përkundër asaj që kjo çështje juridike-administrative ishte kthyer në rivendosje tek e paditura, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A nr. 164/2014 i datës 16.01.2018, në rivendosje e paditura ka nxjerr prapë vendimin e kontestuar në kundërshtim me pikëpamjet juridike të gjykatës dhe vërejtjet e dhëna, dhe në të këtë mënyrë e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LKA-së, ku parashihet karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit. Gjykata i konsideron si veprime të njëanshme kur e paditura në ri procedurë në vendimin e kundërshtuar në njërën anë pohon realizimin e rimbursimit të periudhës kontestuese 04/2004 për TVSH-ë, të shumës prej 4,149.81 euro, dhe atë në një periudhën tjetër tatimore, respektivisht në periudhën 05/2007 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me kryerjen e transaksioneve debi-kredi me datë 29.05.2009, ndërsa në anën tjetër nuk deklarohet fare për dokumentet “rregullimet që bëhen”, të inspektorit tatimor të datave 12.07.2012 dhe 14.09.2012, edhe pse sipas këtyre dokumenteve vlera për rimbursim për periudhën kontestuese për TVSH-ë, është dashur të jetë 5,528.23 euro e jo 4,149.81 euro, siç ka vepruar Departamenti i Ankesave të ATK-së, këtu e paditura. Tutje duke qenë se tatimpaguesi këtu paditësi sipas marrëveshjes për pagesën e borgjeve tatimore me këste e datës 21.12.2008, e ka paguar totalin e obligimeve prej 63,322.00 euro (baza tatimore dhe interesi), ndërsa sipas BPR-së, Gjykatës dhe vet të paditurës obligimi tatimor bashkë me interesin është vërtetuar të ketë qenë në shume prej 57,793.77 euro, ku rrjedh se : tatimpaguesi këtu paditësi e ka paguar më tepër shumën prej (63,322.00 euro – 57,793.00 euro), = 5,529.00 euro, e e cila shumë është dashur ti pranohet si kreditim me të drejtë rimbursimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, ekspertizës financiare si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është plotësisht e bazuar dhe e drejtë dhe se e paditura nuk ka vepruar drejtë dhe sipas ligjit, andaj gjykata në përputhje me dispozitat e nenit 46 par.4 të LKA-së, ka vendosur që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimin e ATK-së me nr.63/2018 i datës 04.04.2018 si në dispozitivin e Aktgjykimit të shkallës së parë.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 38 dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative si në vështrim të nenit 43.1 të LKA-së si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore ku pa dyshim vërtetohet se, në bazë dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, ekspertizës financiare të datës 14.01.2021, dhe deklarimit të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 25.05.2021, nga ana e ekspertit financiar M.P., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi profesional për secilën pikë veq e veq. Sipas ekspertit nga e paditura ATK-ë është bërë zbatim i vendimit të BPR-së, nr. 50/2009 datë 09.12.2010, tutje se gjendja faktike e parapagimit 04/2004 si periudhë kontestuese është shumë prej 5,528.23 euro, nga kjo vlerë është rimbursuar shuma

prej 4,149.81 euro, pra nga periudha kontestuese në periudhën 05/2007, ndërsa si vlerë e mbetur e parapagimit për periudhën kontestuese 04/2004 ka mbetur edhe vlera prej 1,178.42 euro. Këtë vlerë ekspertit e ka konfirmuar edhe me dokumentet “rregullimet që bëhen” të datës 12.07.2012 dhe 14.09.2012, pra sipas këtij dokumenti të datës 14.09.2012, vlera e parapagimit është 5,528.23 euro, derisa sipas ekspertizës së ekspertit Financiar të datës 24.11.2017, në procedurën sipas lëndës A nr. 164/2014, parapagimi është 4,149.81 euro, e cila është bazuar në dokumentin “detajet e vlerësimit”, e proceduar me datë 16.06.2011 (faq-6 e ekspertizës së datës 24.11.2017). Diferenca e paraqitur në mes të këtyre dy dokumenteve në vlerë prej 1,378.42 euro është sepse kalkulimi i parapagimit nga ana e E/F zt. V.I. është bërë vetëm për muajin 04-2004. Si përfundim ekspertit financiar për periudhën kontestuese 04/2004 për TVSH-ë paraqet këtë mendim se “Vlera e parapagimit e periudhës 04-2004 për kthim : 1,378.42 euro, andaj Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të ekspertit M.P., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat. Tutje Gjykata ka konstatuar se mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuara dhe i drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për njohjen edhe të shumës së mbetur nga periudha kontestuese 04/2004, si kreditim me të drejtë rimburesimi. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroj të paditurën që paditësit ti njoh si kreditim me të drejtë të rimburesimi shumën e mjeteve të paguar më tepër dhe e cila nuk i është rimburesuar në shumën e tërësishme për periudhën kontestuese 04/2004 për TVSH-ë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e

drejta dhe ligji në dëm të paditurës. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 49 të LKA-së , dhe neni 200, i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.973/22, me datë 05.12.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**